



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2022:282620  
Datë: 05.02.2025  
Numri i dokumentit: 06809694

**C.nr. 1118/22**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA VITI**, gjyqtari Arben Xheladini me bashkëpunëtoren profesionale, Bionda Rexhepi, në çështjen kontestimore të paditëses Z.P., nga K., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Hajriz Lubishtani, avokat në Viti, kundër të paditurës Komuna e Klllokotit, me objekt kontesti kompensim i pagave, i ushqimit ditorë dhe udhëtimit, vlera e objektit të kontestit 2,439.60 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 29.01.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. Miratohet kërkesëpadia e paditëses Z.P., kundër të paditurës Komuna e Klllokotit, detyrohet e paditura që paditëses, në emër të pagave të papaguara, për muajin gusht dhe shtator të vitit 2021, t'ia paguaj shumën prej 369 euro, për muaj, përkatësisht, shumën e përgjithshme, prej 739.60 euro, në emër të ushqimit ditorë për periudhën prej 04.04.2018-31.08.2021, për 500 ditë pune t'ia paguaj shumën prej 1,000.00 Euro dhe, 70% të biletës së trafikut urban në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën prej 04.04.2018-31.08.2021, për 500 ditë pune, shumën prej 700.00 Euro, të gjitha në shumën e përgjithshme prej 2,439.60 Euro, në afat prej shtatë ditëve, nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

II. Detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 279 Euro.

**A r s y e t i m**

Paditësja Z.P., nga K., përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, me datë 28.11.2022 ka paraqitur padi për kompensim e pagave, ushqimit ditorë dhe udhëtimit. Në seancën e shqyrtimit kryesor ka bërë zvogëlimin e kërkesëpadiës, ku ka kërkuar nga Gjykata, t'ia aprovojë kërkesëpadinë e paditëses për kompensimin e pagave të papaguara për muajin gusht dhe shtator të vitit 2021, t'ia paguaj nga 369 euro, për muaj, përkatësisht shumën e përgjithshme, prej 739.60 euro, kurse kompensimin e ushqimit ditorë nga 2 Euro në ditë, për 500 ditë pune, të llogaritur nga data 04.04.2018-31.08.2021, në shumën prej 1,000.00 Euro, si dhe shpenzimet e udhëtimit 70% të biletës së udhëtimit për 500 ditë pune, shumën prej 700 Euro, duke u bazuar në nenin 35, par. 5 dhe 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, për shkak se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, e gjithashtu edhe për faktin se deri më tani, përkundër kërkesës para fillimit të procesit kontestimor, e paditura nuk i ka kompensuar kërkesat e paditëses. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar: për përpilim të padisë 104 euro, për taksë gjyqësore 40

euro dhe për dy seanca secila nga 135 euro, shumën prej 270 euro, në shumë të përgjithshme prej 379 euro, sipas tarifës së OAK-së.

E paditura në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses Z.P., duke e cilësuar si të pa bazë ligjore për faktin se DKA-Komuna e Klllokotit nuk është përgjegjëse për moszbatimin e kontratës kolektive të vitit 2017, të cilën e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe SBASHK, duke theksuar se Ministria e Arsimit, si palë nënshkruese e Kontratës Kolektive, ka qenë përgjegjëse që për të siguruar buxhet shtesë për zbatimin e kësaj kontrate. Në shqyrtim gjyqësor, e paditura ka theksuar se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditëses dhe se paditësja nuk ka dëshmi që për periudhën si në kontrata ka punuar dhe se të gjitha kontratat janë nënshkruar nga ish-drejtori i arsimit. Tutje ka theksuar se paditësja është e punësuar dhe gjithmonë ka punuar sipas sistemit paralel serb. Gjithashtu, e paditura ka theksuar se sipas Ligjit të Punës neni 78.1, punëmarrësi që konsideron se i është shkelur një e drejtë, e ka afatin e caktuar se kur mund ta ushtroj të drejtën e saj, andaj ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: kontratat të dt. 04.04.2018, 01.09.2018, 01.09.2019, 01.10.2019, 01.09.2020, 01.09.2021; biletat e udhëtimit; kërkesën e datës 18.11.2022; qarkullimin bankar të dt. 23.09.2022; vërtetimet nr. 184/1, dt. 20.01.2025, 188/1 dhe 189/1, dt. 23.01.2025 dhe 25.01.2025; lista e pagave për periudhën qershor-dhjetor 2019; lista e pagave për muajt qershor, korrik dhe tetor 2021.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-së, gjykata e vërtetoi kërkesëpadia e paditëses Z.P., është e themeltë.

Nga provat materiale të administruara u vërtetua kjo gjendje faktike: se paditësja nuk është paguar për muajt gusht dhe shtator të vitit 2021; se në periudhën prej 04.04.2018-31.08.2021 ka qenë e pranishme në punë 500 ditë, ndërsa, për të shkuar në punë udhëton në relacionin Klllokot-Verbovc dhe anasjelltas, e çmimi i trafikut urban në dy drejtimet është 2 euro.

Fakti se paditësja, nuk është paguar për muajt gusht dhe shtator të vitit 2021, u vërtetua nga lista e pagave për muajt qershor, korrik dhe tetor të vitit 2021, e që për muajt gusht dhe shtator edhe sipas evidencës së Komunës së Klllokotit nuk është paguar.

Fakti se paditësja, nga data 04.04.2018-31.08.2021, ka 500 ditë të pranisë në punë, u vërtetua nga vërtetimet me numër 184/1, dt. 20.01.2025, 188/1 dhe 189/1, dt. 23.01.2025 dhe 25.01.2025, të lëshuar nga Drejtori i shkollës.

Faktin se paditësja udhëton për në vendin e punës nga vendbanimi i saj në Klllokot deri në vendin e punës në Verbovc dhe anasjelltas, dhe se bileta e trafikut urban është 2 Euro në të dy drejtimet Klllokot-Verbovc, gjykata e vërtetoi përmes Kuponave Fiskal të lëshuar nga N.T “ALEKS S&S travel” në Klllokot.

Meqenëse në bazë të provave të administruara u vërtetua gjendja faktike, gjykata e detyroi të paditurën që paditëses në emër të dy pagave të papaguara, për muajt gusht dhe shtator të vitit 2021, t'ia paguajë shumën prej 739.60 euro, nga 369 euro për muaj; në emër të ushqimit për 500 ditë, t'ia paguajë shumën prej 1,000.00 Euro; si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për në vendin e punës, 70% të biletës së trafikut urban, t'ia paguajë shumën prej 700.00 Euro.

Po ashtu gjykata vërtetoi se e paditura nuk ia ka paguar paditëses pagat për muajt gusht dhe shtator të vitit 2021, duke u bazuar në listën e pagave për muajt qershor, korrik dhe tetor të vitit 2021, të lëshuara nga Komuna e Klllokotit dhe përgjigjes në kërkesë nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Klllokotit, nr.184/1 të dt.20.01.2025.

Me rastin e vendosjes për kompensimin e ushqimit, Gjykata u bazua në nenin 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, i cili ka paraparë kompensimin e ushqimit në punë nga 2 Euro për një ditë pune, ndërsa për kompensimin e shpenzimeve për biletat e udhëtimit për në vendin e punës Gjykata u bazua në 35 pika 5, i cili ka paraparë se “punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”.

Gjykata, me qëllim të zbatimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, nuk caktoi ekspert financiar, pasi nuk kishte propozim nga palët ndërgjyqëse dhe se llogaritja e shumave është bërë sipas matematikës së thjeshtë; për muajt gusht dhe shtator, nga 369 euro për muaj, në shumë të përgjithshme prej 739.60 euro, për kompensimin e ushqimit për 500 ditë x 2 Euro e nxorri shumën prej 1,000.00 Euro, ndërsa për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit 70% e biletës së trafikut urban për 500 ditë x 1 Euro, për një drejtim, në relacionin Klllokot-Verbovc dhe anasjelltas, shumën e përgjithshme prej 700 Euro.

Gjykata, sa i përket dy pagave mujore, ka miratuar lartësinë e kërkuar nga paditësja, bazuar në faktin se nga lista e pagës për muajin korrik dhe tetor 2021 konstatohet se paga bazë e paditëses është 459.00 Euro, prandaj meqë kërkesa e paditëses është më e ulët sesa paga që evidentohet në listë, gjykata vlerëson se çdo vendosje ndryshe do të përbënte tejkalim të kërkesëpadisë. Lidhur me lartësinë sa i përket shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, gjykata në mungesë të vërtetimit të lëshuar nga e paditura për të konstatuar saktë ditët e pranisë në punë të paditëses për këtë periudhë kohore (përkundër se e paditura ka qenë e detyruar me aktvendim procedural të seancës përgatitore të datës 15.01.2025), e miratoi lartësinë e kërkuar nga paditësja, duke u bazuar në kërkesën e paditëses se për periudhën 04.04.2018-31.08.2021 ka qenë e pranishme 500 ditë në punë, ndërsa nuk është kompensuar për shpenzime të ushqimit dhe udhëtimit, përkundër detyrimit që të paditurës i ka rrjedhë nga Kontrata Kolektive e Arsimit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës, të cilat u gjetën të pa bazuara, për shkak se palët kontraktuese të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)), në nenin 2 të kësaj Kontrate kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe

institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Sipas kësaj, e paditura është e lidhur me detyrimet që burojnë nga kjo kontratë”.

Pretendimin e të paditurës se paditësja e ka kaluar afatin për paraqitjen e kërkesës së saj, duke u bazuar në nenin 78.1 të Ligjit të Punës, gjykata e vlerësoi të pabazuar, pasi kërkesa e paditëses është monetare, ndërsa ai nen ka të bëjë me veprimet që duhet ndër marrë kundër vendimeve të punëdhënësit e që cenojnë vetë marrëdhënien e punës.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452, 453.1 dhe 463 të LPK-së, që përcakton se “Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”, pasi ka vlerësuar se shpenzime të domosdoshme kanë qenë: taksa për padi 40 Euro, përpilimi i padisë 104 Euro dhe një seancë 135 Euro, duke marrë parasysh zvogëlimin e kërkesëpadisë së paditësit në shqyrtimin kryesor.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA VITI**  
**C.nr. 1118/2022, datë 29.01.2025**

**Gjyqtari,**

**Arben Xheladini**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, duke llogaritur pas ditës së pranimit të këtij vendimit. Ankesa eventuale dorëzohet përmes kësaj gjykate.